



SHËNIMET SHPJEGUESE PËR PASQYRAT FINANCIARE TË VITIT USHTRIMOR 2020

Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK 2 i permiresuar. Plotesimi i te dhenave të kësaj pjese duhet të bëhet sipas kërkesave dhe strukturës standarte të percaktuara ne SKK 2 te permiresuar. Rradha e dhenies se spjegimeve duhet te jete:

- a) Informacion i përgjithshëm dhe politikat kontabel
- b) Shënimet qe shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare
- c) Shënime të tjera shpjeguese

Informacion i përgjithshëm

1. Kuadri ligjor: Ligji 9228 dt 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"
2. Kuadri kontabel i aplikuar: Standartet Kombetare te Kontabilitetit te Permiresuara ne Shqiperi. (SKK 2)
3. Baza e pergatitjes se PF: Te drejta dhe detyrimet e konstatuara. (SSK 1)
4. Parimet dhe karakteristikat cilesore te perdorura per hartimin e P.F.: (SKK 1)
 - a) NJESIA EKONOMIKE RAPORTUSE ka mbajtur ne llogarite e saj aktivet, pasivet dhe transaksionet ekonomike te veta.
 - b) VIJIMESIA e veprimtarise ekonomike te njesise sone raportuse eshte e siguruar duke mos pasur ne plan ose nevojte nderprerjen e aktivitetit te saj.
 - c) KOMPENSIM midis nje aktivi dhe nje pasivi nuk ka, ndersa midis te ardhurave dhe shpenzimeve ka vetem ne rastet qe lejohen nga SKK.
 - d) KUPTUSHMERIA e Pasqyrave Financiare eshte realizuar ne masen e plote per te gene te qarta dhe te kuptushme per perdorues te jashtem qe kane njohuri te pergjitheshme te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.
 - e) MATERIALITETI eshte vleresuar nga ana jone dhe ne baze te tij Pasqyrat Financiare jane hartuar vetem per zera materiale.
 - f) BESUSHMERIA per hartimin e Pasqyrave Financiare eshte e siguruar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e meposhteme:
 - Parimin e paraqitjes me besnikeri
 - Parimin e perparetise se permbajtjes ekonomike mbi formen ligjore
 - Parimin e paaneshmerise pa asnje influencim te qellimshem
 - Parimin e maturise pa optimizem te teperuar, pa nen e mbivleresim te qellimshem
 - Parimin e plotesise duke paraqitur nje pamje te vertete e te drejte te PF.
 - Parimin e qendrueshmerise per te mos ndryshuar politikat e metodat kontabel
 - Parimin e krahasueshmerise duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Universiteti "Luarasi", Tiranë është krijuar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me vendim Nr. 28233, datë 02.09.2002 të Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë, me emërtesë "Shkolla e Lartë Universitare Jopublike "UNIVERSITETI LUARASI" sh.p.k, NIPT K31526058G, me ortak të vetëm Panorama Group sha dhe administrator Z.Kino Buxheli. Kapitali themeltar sipas ndryshimeve në vite, paraqitet sot në vlerën përkatëse 86.668.211 Lekë.

2. DEKLARATË E PAJTUESHMËRISË ME SKK-të

Pasqyrat financiare (*individuale*) për qëllime të përgjithshme janë përgatitur dhe paraqiten në përputhje me *Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara* dhe me kërkesat e *ligjit 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"*.

3. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike, duke e kombinuar me elementë të metodave të tjera, dhe parimit të të drejtave dhe detyrimeve të kostatuara. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar (Lekë).

4. PARIMI I VIJIMËSISË

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë, që do të thotë se veprimtaria ekonomike e shoqërisë do të ketë vijimësi të aktivitetit të saj për 12 muaj pas datës së hartimit të Pasqyrave Financiare 2020.

5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

a) Të përgjithshme

Këto pasqyra financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike dhe në përputhje me Standardet Shqiptare të Kontabilitetit të Përmirësuara . Këto pasqyra financiare janë paraqitur në LEK Shqiptar ("LEK") që është monedha raportuese e Shoqërisë.

- Për përcaktimin e kostos së inventarëve është zgjedhur metoda "FIFO" (hyrje e parë, dalje e parë. (SKK 4)
- Vlerësimi fillestar i një elementi të AAM që plotëson kriteret për njohje si aktiv në bilanc është vlerësuar me kosto. (SKK 5; 11)
- Për prodhimin ose krijimin e AAM kur kjo financohet nga një hua, kostot e huamarrjes (dhe interesat) është metoda e kapitalizimit në koston e aktivit për

periudhën e investimit. (SKK 5)

- Për vlerësimin e mëpasëshëm të AAM është zgjedhur modeli i kostos duke i paraqitur në bilanc me kosto minus amortizimin e akumuluar. (SKK 5)
- Për llogaritjen e amortizimit të AAM (SKK 5) njësia jonë ekonomike ka përcaktuar si metodë të amortizimit të ndërtesave metodën lineare dhe për AAM të tjera metodën e amortizimit mbi bazën e vleftës së mbetur ndërsa normat e amortizimit janë përdorur të njëjllota me ato të sistemit fiskal në fuqi dhe konkretisht :
 - Për ndërtesat me 5 % të vleftës së mbetur
 - Kompjutera e sisteme informacioni me 25 % të vleftës së mbetur
 - Të gjitha AAM të tjera me 20 % të vleftës së mbetur
- Për llogaritjen e amortizimit të AAJM (SKK 5) njësia ekonomike raportuese ka përcaktuar si metodë të amortizimit metodën lineare më normën e amortizimit me 15 % në vit.
- Për njohjen e të ardhurave në periudhën raportuese është përdorur SKK1 **PARIMET BAZË PËR PËRGATITJEN E PASQYRAVE FINANCIARE** paragrafi 40-43 dhe SKK 8 /të ardhurat.

b) Të ardhurat

Në rastet kur rezultati i një transaksioni që përfshin ofrimin e shërbimeve mund të matet me besueshmëri, të ardhurat e lidhura me këtë transaksion njihen në varësi të fazës së përfundimit të shërbimit në fund të periudhës së raportimit. Rezultati i një transaksioni mund të matet me besueshmëri kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

(i) shumat e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;

(ii) arkëtimi i pagesës nga kryerja e shërbimit është i mundur;

(iii) volumi i kryerjes së shërbimit në datën e bilancit mund të matet me besueshmëri;

(iv) shpenzimet e bëra për shërbimin, si dhe ato që do bëhen për përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat gjenerohen nga shërbimet e ofruara klientëve bazuar në kontratë.

c) Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në LEK me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Të ardhurat dhe humbjet nga kurset e këmbimit, që vijnë për shkak të shlyerjeve të këtyre transaksioneve dhe të rivlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve monetare të shprehura në monedhë të huaj në fund të periudhës, njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë të përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare (LEK kundrejt monedhës përkatëse) për monedhat kryesore më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

	Me 31 Dhjetor 2020	Me 31 Dhjetor 2019
European Union Currency unit (EUR)	123.70	121.77
United States Dollar Currency unit (USD)	100.84	108.64

d) Aktivet afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me blerjen e aktivitet. Kosto përfshin shpenzimet e lidhura direkt me blerjen e aktivitet. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me sjelljen e aktivitet në gjëndje pune për qëllimin e caktuar, kostot e çmontimit dhe lëvizjen e aktiveve të ndryshme dhe kthimin e vendndodhjes së tyre në gjëndjen e mëparshme.

Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

ii. Kostot në vijim

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi njihet ne pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, duke përdorur metodën lineare të amortizimit mbi vlerën e mbetur te aktivitet sipas legjislacionit fiskal ne fuqi , ligji 8438 date 28.12.1998 “Per tatimin mbi te ardhurat i ndryshuar”. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Normat e amortizimit të zbatuara sipas kategorive të aktiveve kryesore , mbi vlerën e mbetur te aktivitet (kosto historike – amortzim akumuluar) janë si më poshtë:

Kategoritë e Aktiveve	2020	2019
Pajisje zyre-mobilje	20%	20%
Pajisje zyre- kompjuter	25%	25%
Patenta, licenca, marka tregtare, etj	15%	15%
Ndertesa	5%	5%

e) Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin aktual është bazuar në shumën e tatimit të pritshëm për t’u paguar llogaritur sipas legjislacionit Shqiptar si dhe përcaktimeve në rregullat bazë kontabël në Shqipëri duke përdorur normën e tatimit të zbatueshëm në datën e hartimit të pasqyrave si dhe çdo rregullim për tatim

fitimin e pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Përqindja e tatim fitimit në fuqi gjatë vitit 2020 ishte 15% (2017: 15%).

f) Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme paraqiten me vlerën neto të realizueshme, që është kosto minus provigjionin për llogaritë e dyshimta në se ka.

g) Mjetet monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë paratë në dorë, depozitat në banka, investimet afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe afat maturimi deri në tre muaj, që janë lehtësisht të konvertueshme në një shumë të njohur mjetesh monetare dhe nuk janë subjekt i riskut të ndryshimit të vlerës së drejtë.

h) Furnitorë dhe detyrime të tjera

Furnitorët dhe detyrimet e tjera paraqiten me kosto për tu paguar .

i) Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabël Shqiptar.

6. MJETE MONETARE

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
1.Arka		
Në LEK	73,286	184,992
Në EUR	39 €	1,230 €
	78,147	334,806
Totali Arka		
2.Banka		
Në LEK	2,725,359	7,770,602
Në EUR	285,452 €	2,872 €
Në \$	3 \$	-53 \$
	38,036,135	8,114,676
Totali Banka		
Totali	38,114,282	8,449,482

Kursi i përdorur në Euro në datë 31.12.2020 është 123.70

Kursi i përdorur në \$ në datë 31.12.2020 është 100.84

Kursi i këmbimit është marrë nga faqja zyrtare e Bankës së Shqipërisë.

7. KLIENTË PËR MALLRA, PRODUKTE E SHËRBIME

Llogaritë e arkëtueshme më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 janë të përbëra si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
1.Të drejta të arkëtueshme “Nga aktiviteti shfrytëzimit (Kliente)”	17,606,048	18,819,788
2.Të drejta të arkëtueshme “Të Tjera”	187,945,873	169,851,081
Totali	205,551,921	188,670,869

“Nga Aktiviteti i Shfrytëzimit (Kliente)” janë pasqyruar studentët e pa arkëtuar.

Këtu bëjnë pjesë:

- Studentë të mbartur nga vitet e tjera akademike, ku sipas kontratës së shërbimit, janë faturuar me faturë tatimore TVSh-je (përfshirë nga TVSH sipas legjislacionit fiskal në fuqi) dhe e kanë të palikujduar detyrimin me vlerë 17,606,048 Lekë.

Ndërsa në zërin “Të Tjera (Debitorë të tjerë)” janë pasqyruar kërkesat debitore ndaj:

- Tatim mbi dividend i mbipaguar me vlerë 603,732 Lekë.
Kjo llogari është tatim mbi dividendët i mbi paguar në periudhën Qershor-Korrik 2011 dhe mbartet deri në këtë vit ushtrimor.
- Garanci Kontrate me vlerë 2,678,500 Lekë

Në këtë llogari janë përfshirë:

Garancia e kontratës me Vodafon me vlerë 8,500 Lekë si edhe garancia e kontratës me METE për godinën e konviktit të shkollës së mesme “Asim Vokshi” me vlerë 2,670,000 Lekë.

- Të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve dhe aksionerëve me vlerë 91,143,273 Lekë.

- Focus Group sh.p.k me vlerë 46,777,526 Lekë
(Kjo llogari është krijuar në vitin ushtrimor 2011 me vlerën 378,153 Euro dhe vazhdon ende e palikujduar.)
- Birra Korca sh.p.k me vlerë 23,317,352 Lekë
- Egnatia sh.a me vlerë 5,004,725 Lekë
- Hysenbelliu sh.p.k me vlerë 12,306,180 Lekë
- Hysenbelliu Group me vlerë 375,000 Lekë
- Focus Media News me vlerë 5,739,585 Lekë

8. **AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (AAM-te)**

Aktivitet afatgjata materiale me vlerë neto 153,146,882 përbëhen nga:

1. Ndërtesa me vlerë 139,208,793 (janë investimet që janë kryer në universitet për godinën e re që është marë në zotërim sipas Kontratës së Qirasë Nr.11436 datë 29.08.2013. Universiteti ka filluar aktivitetin e tij në godinën e re nga dt.01.07.2016 sipas standarit SKK 5 AAM, ndërtesa është amortizuar me 5%.

2. Impiante dhe makineri me vlerë 488,869 (përbën makineri dhe paisje pune me vlerë 124,058 si edhe instalime teknike specifike me vlerë 364,811)

3. Të tjera instalime dhe paisje me vlerë 13,449,220 (përbën mobileri dhe paisje zyre me vlerë 9,208,382 si edhe paisje informatike me vlerë 4,240,838)

Kostoja, amortizimi i akumuluar dhe vlera kontabël neto në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor paraqitet në mënyrë analitike si vijon:

(në LEK)	Ndertesa	Makineri/Paisje Instalime	Mobileri dhe orendi zyre	Paisje informatike	Totali
Kosto					
Më 1 Janar 2020	171,447,292	2,685,344	29,766,748	18,342,538	222,241,922
Shtesa/Pakesime	2,202,204	0	895,320	86,100	3,183,624
Më 31 Dhjetor 2020	173,649,496	2,685,344	30,662,068	18,428,638	225,425,546

Amortizimi i akumuluar

Më 1 Janar 2020	27,162,218	2,146,259	19,356,767	12,796,360	61,461,604
Shpenzimi i vitit	7,278,485	50,217	2,096,918	1,391,440	10,817,060
Më 31 Dhjetor 2020	34,440,703	2,196,476	21,453,685	14,187,800	72,278,664
Vlera kontabël neto					
Më 31 Dhjetor 2019	144,285,074	539,085	10,409,981	5,546,177	160,780,317
Më 31 Dhjetor 2020	139,208,793	488,869	9,208,382	4,240,838	153,146,882

9. AKTIVET AFATGJATA JO-MATERIALE

Nr	Emërtimi	Vlera Fillestare 01.01.2020	Amortizimi 2020	Vlera Kontabël Neto 31.12.2020
1	Patenta, licenca	8,559,123	3,739,061	4,820,062

Aktivitet Afatgjata Jo-materiale përfaqësojnë “Vlerësimin e jashtëm, riakreditimin institucional si edhe akreditimin e programeve të studimit të ciklit të dytë”. Ato janë amortizuar me 15% të vlerës fillestare konform akteve nënligjore fiskale në fuqi. Riakreditimi është amortizuar për 1/6 e vlerës përkatëse fillestare.

“Aktivitet Afatgjata Materiale” dhe “Aktivitet Afatgjata Jo-materiale” pasqyrojnë gjëndjen e aktiveve afatgjata me vlerë të mbetur. Metoda e përdorur është “Metoda e Kostos” dhe vlera e paraqitur në pasqyrat financiare përfaqëson vlerën e mbetur pasi është zbritur amortizimi i akumuluar për periudhat e shfrytëzimit.

10. DETYRIME AFATSHKURTRA

Llogaritë e pagueshme më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
1. Detyrime ndaj institucioneve të kredisë (Garancia Sovrane e marrë gjatë periudhës së pandemis në BKT)	14,615,342	-
2. Furnitorë të ndryshëm (Në këtë vlerë janë përfshirë faturat dhe detyrimet e lindura kryesisht gjatë vitit 2019-2020 që do të paguhën në periudhat vijuese.	15,811,338	48,505,430
3. Të pagueshme ndaj punonjësve (paraqet detyrimet e mbetura pa u paguar ndaj personelit me vlerë 18,371,557 Lekë si dhe honoraret e Bordit Administrimit me vlerë 767,111 Lekë)	19,138,668	11,956,701
4. Detyrime për Sigurime Shoq.Shënd. (paraqet detyrimin e muajit Dhjetor 2020)	2,117,383	2,174,048
5. Detyrime tatimore për TAP-in (paraqet detyrimin e muajit Dhjetor 2020)	1,035,131	1,104,355
6. Detyrime tatimore për Tatim Fitimin (paraqet detyrimin per vitin fiskal 2020)	7,064,553	840,046
7. Detyrime tatimore për Tatimin në Burim (detyrim i mbartur nga viti fiskal 2013 me vlerë 360 Lekë si edhe detyrimin e muajit Dhjetor 2020)	135,739	106,475

8. Të ardhura të shtyra

(përfshin parapagimet e tarifave të shkollimit për periudhën që i përket vitit akademik 2020-2021)

114,814,538

102,457,831

Totali

174,732,692

167,144,886

Të ardhura të shtyra:

Duke qënë se shkolla i krijon të ardhurat mbi bazë viti akademik, dhe kjo periudhë është e ndryshme nga viti ushtrimor për të cilin plotësohen edhe pasqyrat financiare, këto të ardhura janë regjistruar në kontabilitet në llogarinë “Të ardhura të shtyra”, që reflektojnë shpërndarjen e kështit në simestër ku data 31 Dhjetor përkon me gjysmën e programit për semestrin e parë.

Universiteti “Luarasi” harton kontrata me cdo student të regjistruar dhe sipas kësaj kontrate këstet për një tarifë të caktuar studimi për vitin akademik 2020-2021 janë të parashikuara që të faturohen me fillim e shkollës në Tetor 2020 dhe fillimin e semestrit të dytë në Mars 2021.

Sipas Standardit të Kontabilitet Kombëtar Nr.8 Te Ardhurat,

FUSHA E ZBATIMIT

4. Ky standard zbatohet për kontabilizimin e të ardhurave që vijnë nga veprimet dhe ngjarjet e mëposhtme:

(a) shitja e produkteve dhe mallrave;

(b) kryerja e shërbimeve

PËRKUFIZIMET KRYESORE

6. Më poshtë jepen përkufizimet e termave kryesore, të përdorura në këtë standard.

Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto, të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitalit (këtu nuk përfshihen rritjet, që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital)
Marrëveshja për kryerjen e shërbimeve është një marrëveshje e lidhur mes palëve për kryerjen e një ose një sërë shërbimesh të ndërlidhura.

NJOHJA E TË ARDHURAVE

8. Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri.

KRYERJA E SHËRBIMEVE

Kontratat e shërbimit

20. Kur rezultati i një transaksioni që përfshin ofrimin e një shërbimi mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, një njësi ekonomike do të njohë të ardhurat e lidhura me transaksionin duke iu referuar fazës së përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese (nganjëherë referuar si metoda epërqindjes së përfundimit).

32. Kur rezultati i një kontrate shërbimi apo ndërtimi nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme:

(a) një njësi ekonomike duhet të njohë të ardhurat vetëm në masën e kostove të kryera të kontratës, te cilat është e mundur të rikuperohen, dhe (b) njësi ekonomike duhet të njohë kostot e kontratës si një shpenzim në periudhën në të cilën ato janë kryer

Sipas / SKK 1 KUADRI I PËRGJITHSHËM PËR PËRGATITJEN E PASQYRAVE FINANCIARE

PARIMET BAZË PËR PËRGATITJEN E PASQYRAVE FINANCIARE

40. Neni 10 i Ligjit të Kontabilitetit Nr. 9228

“Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” përcakton parimet-bazë për mbajtjen e kontabilitetit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare, në përputhje me këtë ligj, si dhe me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, publikuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. Paragrafët 40 deri 90 përshkruajnë këto parime-bazë. Asnjë nga paragrafët e këtij seksioni (paragrafët 40 deri 90) nuk kanë përparësi ndaj ndonjë kërkesë specifike të paragrafëve të tjera të SKK 1 ose ndonjë SKK-je tjetër. Supozime dhe konsiderata të përgjithshme

Konstatimi i të drejtave /detyrimeve dhe përputhshmëria

41. Me qëllim që të përmbushin objektivat e tyre, pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj metode, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (dhe jo kur paraja ose ekuivalentet e saj arkëtohen ose paguhen) dhe njihen në kontabilitet e raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin. Pasqyrat financiare, të përgatitura në bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, i informojnë përdoruesit jo vetëm mbi transaksionet e shkuara të shoqëruara me arkëtime dhe pagesa, por edhe mbi detyrimet për t'u paguar në të ardhmen si dhe mbi aktive që do të sjellin arkëtime në të ardhmen. Në këtë mënyrë, ato paraqesin informacione mbi transaksionet dhe ngjarjet e shkuara të cilat u shërbejnë përdoruesve më së miri në marrjen e vendimeve ekonomike.

42. Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e fituara gjatë periudhës raportuese njihen në të njëjtën periudhë kontabël si dhe të ardhurat përkatëse. Shpenzimet e kryera gjatë një periudhe raportuese, që ndryshon nga periudha kur ato i sjellin përfitime njësisë ekonomike, regjistrohen si shpenzime pikërisht në periudhën kur merren përfitimet.

43. Shpenzimet njihen në të njëjtën periudhë kontabël si dhe të ardhurat që lidhen me to. Nëse të ardhurat që lidhen me shpenzime të caktuara nuk mund të përcaktohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, atëherë për njohjen e tyre do të përdoren mënyra të tërthorta.

Pra, sa me sipër, të ardhurat shpërndahen respektivisht në periudhën e kryerjes së shpenzimit për të përfituar këto të ardhura. Për këtë arsye këto të ardhura nuk janë përfshirë në këtë rezultat financiar të shoqërisë, por në periudhat në vazhdim, duke rimarë në këtë periudhë ushtrimore, të ardhura të shtyra nga viti i kaluar akademik.

11. DETYRIME AFATGJATA

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
1. Detyrime afatgjata ndaj institucioneve të kredisë		
(Kredia që ka shoqëria pranë Bankës Intesa Sanpaolo me vlerë 500,000 €)	37,423,937	48,266,557
2. Debitorë dhe Kreditorë të tjerë		
(Në bazë të kontratave të huasë, ky është detyrimi që universiteti ka ndaj kompanive të Grupit si Alb Ms 97 sh.a me vlerë 7,368,395, Melita shpk me vlerë 2,000,000 Lekë si edhe me Erjoni shpk me vlerë 38,802,609 Lekë, si dhe 3 muaj pagese paradhënie nga Rupizen shpk sipas kontrates me vlerë 296,880)	48,467,884	61,131,245
Totali	85,891,821	109,397,802

12. KAPITALI

Kapitali më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
1.Kapitali i nënshkruar	86,668,211	71,117,855
2.Fitimi i pashpërndarë	-	-
3.Fitimi i vitit	54,340,424	15,550,356
Totali	141,008,635	86,668,211

Kapitali i regjistruar i shoqërisë, i paraqitur në pozicionin financiar, është rritur në krahasim me atë të përcaktuar në statutin e shoqërisë dhe vendimet e depozituara në Q.K.R. Në vitin 2020 me vendim të ortakut të vetëm shoqëria ka përdorur fitimin e vitit 2019 me vlerë 15,550,356 Lekë për të zmadhuar kapitalin duke e ndryshuar atë nga vlera fillestare 71,117,855 Lekë në 86,668,211 Lekë. Ky ndryshim pasqyrohet edhe te “Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto”.

13. TË ARDHURAT NGA AKTIVITETI I SHFRYTËZIMIT

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2020
1.Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	217,344,702	175,787,656
2.Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	5,882,170	6,787,021
Totali	223,226,872	182,574,677

Të ardhurat e realizuara gjatë ushtrimit, sipas kategorive të biznesit paraqiten si vijon:

1. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit me vlerë 217,344,702

Këtu bëjnë pjesë shitjet neto për periudhën Janar 2020 – Dhjetor 2020 me vlerë 122,493,117 Lekë si edhe “Të ardhurat e shtyra” nga viti 2019 me vlerë 94,851,585 Lekë të cilat i përkasin periudhës Janar-Mars 2020 për këtë arsye janë kaluar në të ardhura të vitit. Në shitjet neto janë të përfshira tarifat e studentëve. Duke qënë se viti akademik nuk përputhet me vitin fiskal bën që vlera totale e “Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit” mos të përputhet me totalin e vlerës së deklaruar në librat e shitjes. Diferenca e vlerës midis “Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit” dhe FDP-ve është pikërisht vlera e cila pasqyrohet në pasqyrën e bilancit në zërin “Të ardhura të shtyra”.

Të ardhurat përbëhen nga:

- Të ardhura të rimara nga viti 2019 (Viti akademik 2019-2020 pjesë e Këstit të parë që i përket periudhës Janar-Mars 2020)
 - Kesti i dytë për vitin akademik 2019-2020
 - Vetëm pjesa e Këstit të parë për vitin akademik 2020-2021 që i përket periudhës Tetor-Dhjetor 2020.
2. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit me vlerë 5,882,170 Lekë përbëhet nga:
- Të ardhura nga trajnimet me vlerë 124,994 Lekë
 - Tarifa të tjera me vlerë 4,356,568 Lekë ku përfshihen të gjitha dokumentat e kërkuara nga studentët në sekretari si certifikata, vërtetim diplome, tarifë regjistrimi, tarifë riprovimi dhe tarifë karton diplome etj.

- Të ardhura nga provimi “APTIS” me vlerë 951,173 Lekë përfshin tarifën e marë për studentët që marin pjesë në provim.
- Të ardhura nga kontrata e huapërdorjes me shoqërinë Rupizen shpk me vlerë 449,436 Lekë

14. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
1.Pagat e personelit	98,517,519	98,544,737
1.1 Honorare Bordi Administrimit	9,979,268	8,883,448
2.Shpenzimet për Sig.Shoq. Shënd.	12,202,643	12,180,726
Totali	120,699,430	119,608,911

16. SHPENZIME TË TJERA

Shpenzime të tjera për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
1.Shpenzime qiraje	10,680,000	10,680,000
2.Materiale konsumi (energji, ujë, karburant)	2,380,138	2,696,506
3.Shpenzime financiare	2,058,006	3,851,459
4.Shpenzime konsumi & amortizimi	11,645,877	12,826,041
5.Të tjera	11,344,771	14,125,554
Totali	38,108,792	44,179,560

Të tjera: përfshin shpenzimet si kancelari, shërbimi rojeve, shërbimi internetit dhe telekom, publicitet, ceremoni diplomimi, botimet, guida e studimit, shërbimi rojeve, shërbime noteriale, shërbim dezinfektimi, aksesori pastrimi, shërbim printimi, etj.

17. TATIMI MBI FITIMIN

Tatimi mbi fitimin është i pagueshëm në normën 15% bazuar mbi fitimin neto për periudhën dhe korigjuar për efekte tatimore në përputhje me Legjislacionin Shqiptar tatimor në fuqi:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Fitimi para tatimit	64,418,651	18,786,217
Shpenzime të panjohura	2,769,529	2,786,192
Fitimi (humbja) i tatueshëm	67,188,180	21,572,409
Humbje të mbartura		
Tatim fitimi i llogaritur 15%	10,078,227	3,235,861
Fitimi Neto	54,340,424	15,550,356

Shoqëria është e përjashtuar nga TVSH, sipas ligjit "Për TVSH" në fuqi për arsimin, duke qënë se aktiviteti i shoqërisë është tërësisht në fushën e arsimimit;

Ligji 92/2014 date 22.05.2014 për tvsh "Furnizimet e përjashtuara"
Neni 51
Përjashtimi i disa veprimtarive me interes të përgjithshëm

g) furnizimi i shërbimeve të edukimit të fëmijëve dhe të rinjve, të mësimdhënies shkollore apo universitare, formimit profesional dhe rikualifikimit, përfshirë furnizimin e shërbimeve dhe mallrave ngushtësisht të lidhura me to nga institucionet arsimore, publike dhe private, të njohura si të tilla nga autoriteti kompetent shtetëror, në përputhje me legjislacionin përkatës të fushës;

Shpenzime të panjohura (të pazbritshme) fiskale :

Në kategorinë “Shpenzime të panjohura” janë shpenzimet pa dokumentacion mbështetës sipas formatit të aprovuar nga autoritetet fiskale. Këto lloj shpenzimesh janë efektivisht kosto efektive për shoqërinë , por të pazbritshme për qëllime tatimore.

Në shpenzimet e panjohura me vlerë totale 2,769,529 Lekë bëjnë pjesë:

• Shpenzime pa faturë tatimore ose të panjohura fiskalisht me vlerë	120,183 Lekë
• Gjoha me vlerë	96,679 Lekë
• Shpenzime për interesa “Hua Afatgjatë” me vlerë	2,453,647 Lekë
• Penalitete Kredie me vlerë	5,213 Lekë
• Sigurimi i “Jetës për Kredinë” me vlerë	93,807 Lekë

18. TRANSAKSIONET ME PALET E LIDHURA

Transaksionet me palët e lidhura përfaqësojnë transferim të burimeve, shërbimeve, ose detyrimeve midis palëve të lidhura, pavarësisht nëse vendoset apo jo një çmim. Një palë e lidhur është një palë, e cila kontrollon, kontrollohet, ose është nën një kontroll të përbashkët me njësinë tregtare; ka një interes mbi njësinë që i jep një influencë të rëndësishme mbi entitetin; ose ka një kontroll të lidhur mbi entitetin; është ortak në shoqëri; është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën entiteti është sipërmarrës; ose është një anëtar i personelit drejtues të entitetit, ose mëmës së tij (duke përfshirë familjarët e afërm të çdonjërit prej individëve të sipërpërmendur).

Palë të lidhura janë të evidentuara dhe paraqiten në aktiv të Pasqyrave Financiare në vlerat si vijon ;

- Focus Group sh.p.k me vlerë 46,777,526 Lekë
- Birra Korca sh.p.k me vlerë 23,317,352 Lekë
- Egnatia sh.a me vlerë 5,004,725 Lekë
- Hysenbelliu sh.p.k me vlerë 12,306,180 Lekë
- Hysenbelliu Group me vlerë 375,000 Lekë
- Focus Media News me vlerë 5,739,586 Lekë

në Pasiv të Pasqyrave Financiare në vlerat si vijon ;

- Alb MS 97 sha me vlerë 7,368,395 Lekë
- Melita shpk me vlerë 2,000,000 Lekë
- Erjoni shpk me vlerë 38,802,609 Lekë

19. NGJARJET PAS DATËS SË BILANCIT

Asnjë ngjarje e rëndësishme nuk ka ndodhur pas datës së hartimit dhe miratimit të pasqyrave financiare 2020.

20. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË MUNDSHME

Shoqëria nuk ka angazhime dhe detyrime të mundshme që kërkojnë paraqitje në pasqyrat financiare.

21. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

a) Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit pasi transaksionet ndodhin në të dyja monedhat, si ajo vendase dhe ajo e huaj. Manaxhimi monitoron dhe vendos limitin për ekspozimin e lejuar për çdo monedhë dhe në total. Shoqëria nuk angazhohet në kryerjen e veprimeve, apo tregtimin e instrumentave derivative. Më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 shoqëria nuk është shumë e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.

b) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku nga mospërputhja e maturiteteve të aktiveve dhe detyrimeve. Shoqëria monitoron likuiditetin mbi baza periodike në mënyrë që të manaxhojë detyrimet kur ato lindin.

Përgjegjëse Zyrës Financës

Lorena Resuli



ADMINISTRATOR



Kino Buxheli

